

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKES SE KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **102-26-5763-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbime të përkthimit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	FINART SH.P.K.
NUI	810088345
Adresa	Rr. Uran Ajeti 62
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	048644606
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Granit Selmanaj
Adresa elektronike	finartshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	14.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbime të përkthimit

Njoftimi për kontratë - 16.07.2026

Procesverbali i hapjes së tenderëve - 07.08.2026

Vendimi

Kërkesa për rishqyrtim - 17.08.2026

Pergjigje e kërkesës për rishqyrtim - 18.08.2026

Vendimi final - 10.09.2026

Letra standarde për OE të eliminuar -10.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Vendimi i bashkëngjitur.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 56, paragrafi 3 i LPP-së – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave.

Neni 7, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi dhe transparenca

Neni 51, paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes.

Neni 59, veçanërisht paragrafët 2 dhe 4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 69, paragrafët 1, 4 dhe 4.1 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. RRETHANAT FAKTIKE

FINART SH.P.K. ka marrë pjesë si operator ekonomik në aktivitetin e prokurimit “Shërbime të përkthimit”, të zhvilluar nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës.

Pas procesit të vlerësimit/rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur ofertën e FINART SH.P.K. të pasuksesshme, me arsyetimin se, për përkthyesin e propozuar për përkthim shqip–serbisht dhe anasjelltas, është dorëzuar një diplomë universitare me drejtim gjuhë shqipe dhe jo, sipas interpretimit të Autoritetit Kontraktues, diplomë me drejtim gjuhë serbe.

FINART SH.P.K. konsideron se konstatimet dhe eliminimi i bazuar vetëm mbi këtë interpretim janë të pasakta, tepër formaliste dhe në kundërshtim me mënyrën në të cilën duhet të vlerësohet aftësia teknike dhe profesionale e operatorëve ekonomikë.

Personi i propozuar nga FINART SH.P.K. për përkthimet shqip–serbisht dhe serbisht–shqip:

- ka të përfunduar arsimin universitar në një institucion ku procesi universitar është

zhvilluar në gjuhën serbe, në periudhën e ish-Jugosllavisë;

- posedon licencë/vërtetim të vlefshëm si përkthyes/interpreti për gjuhën serbe; dhe
- ka përvojën profesionale të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të përkthimit në kombinimin gjuhësor të kërkuar.

Pra, aftësia e tij profesionale në gjuhën serbe nuk është një pretendim subjektiv i Operatorit Ekonomik, por është e dëshmuar me kualifikim zyrtar profesional dhe licencë të lëshuar nga autoriteti kompetent.

II. INTERPRETIMI I GABUAR I KËRKESËS SË DOSJES SË TENDERIT

Në Dosjen e Tenderit kërkohet që Operatori Ekonomik të ketë së paku një përkthyes për përkthim shqip–serbisht dhe anasjelltas, me përvojë pune.

Në pjesën e dëshmive dokumentare është përdorur formulimi: “CV, kopjen e diplomës universitare – gjuha serbishte, vërtetimet valide për interpret gjyqësor (Dëshmi licenca e vlefshme)”.

Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit e ka interpretuar këtë formulim sikur Dosja e Tenderit të kishte kërkuar shprehimisht “diplomë universitare të përfunduar në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Serbe”. Mirëpo, një kërkesë e tillë, e formuluar në këtë mënyrë, nuk është përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Dosja përdor formulimin “diplomë universitare – gjuha serbishte”, ndërsa Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit i ka dhënë këtij formulimi një kuptim më të ngushtë, duke e barazuar atë ekskluzivisht me diplomën në drejtimin akademik “Gjuhë Serbe”. Në këtë mënyrë, gjatë fazës së vlerësimit është aplikuar një interpretim më kufizues sesa ai që rezulton drejtpërdrejt nga formulimi i dokumentacionit të tenderit.

Vlerësimi i tenderëve duhet të bëhet mbi bazën e kërkesave të përcaktuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, pa shtuar apo riformuluar kërkesa të reja gjatë fazës së vlerësimit. Për rrjedhojë, kërkesa “diplomë universitare – gjuha serbishte” nuk mund të shndërrohet gjatë vlerësimit në një kërkesë më specifike – “diplomë në drejtimin Gjuhë Serbe” – pa qenë kjo e përcaktuar qartë dhe pa ekuivok në dokumentacionin e tenderit.

III. MOSVLERËSIMI I LICENCËS PROFESIONALE PËR GJUHËN SERBE

Autoriteti Kontraktues ka fokusuar vlerësimin pothuajse ekskluzivisht në titullin/drejtimin formal të diplomës universitare dhe nuk i ka dhënë peshën e duhur licencës së vlefshme profesionale për gjuhën serbe.

Kjo qasje nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e kriterit. Në një kontratë për shërbime përkthimi, kriteret e aftësisë teknike dhe profesionale kanë për qëllim të verifikojnë nëse personeli i propozuar ka aftësinë, përvojën dhe kualifikimin profesional për realizimin e

shërbimeve të kërkuara.

Në rastin konkret kemi një person:

- me arsim universitar të zhvilluar në gjuhën serbe;
- me përvojë profesionale relevante; dhe
- me licencë të vlefshme zyrtare për përkthim/interpretim në gjuhën serbe.

Licenca profesionale nuk është dokument deklarativ apo i parëndësishëm. Ajo dëshmon se personi është njohur nga autoriteti kompetent si profesionalisht i aftë për të ushtruar veprimtarinë e përkthyesit/interpreti në gjuhën serbe.

Për këtë arsye, eliminimi i operatorit ekonomik duke anashkaluar këtë provë profesionale dhe duke u mbështetur vetëm në emërtimin formal të drejtimit të diplomës është joproporcional me qëllimin real të kriterit, i cili është të sigurojë se shërbimi shqip–serbisht kryhet nga një person profesionalisht i kualifikuar.

IV. AUTORITETI KONTRAKTUES DUHEJ TË KËRKONTE SQARIM PARA ELIMINIMIT

Edhe nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur dyshim lidhur me përmbajtjen e diplomës, gjuhën në të cilën janë kryer studimet apo raportin ndërmjet diplomës dhe licencës profesionale, çështja nuk duhej të zgjidhej automatikisht me eliminim.

Vetë Dosja e Tenderit, në nenin 28.1, përcakton se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë plotësimin apo sqarimin e certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura në pajtim me nenet 65–71 të LPP-së, për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet objektivisht.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues kishte përpara diplomën universitare të personit të propozuar, licencën e vlefshme të tij për gjuhën serbe dhe CV-në/përvojën profesionale. Nëse kishte dyshim nëse diploma, pavarësisht drejtimit të saj formal, dëshmonte apo jo kualifikimin e kërkuar, kishte mundësi të kërkonte sqarim lidhur me faktin se studimet universitare janë zhvilluar në gjuhën serbe dhe lidhur me statusin dhe fushëveprimin e licencës së përkthyesit.

Një sqarim i tillë nuk do të ndryshonte personin e propozuar, nuk do të shtonte personel të ri dhe nuk do të krijonte një kualifikim pas afatit të tenderimit. Ai vetëm do të sqaronte një gjendje faktike dhe profesionale që ka ekzistuar para dorëzimit të tenderit.

Për këtë arsye, moskërkimi i sqarimit dhe eliminimi i menjëhershëm i FINART SH.P.K. përbëjnë një qasje tepër formaliste dhe cenojnë parimin e vlerësimit objektiv dhe proporcional të dokumenteve të tenderit.

V. SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË, TRANSPARENCËS DHE PROPORCIONALITETIT

Parimet themelore të prokurimit publik kërkojnë trajtim të barabartë, jodiskriminues, transparent dhe proporcional të operatorëve ekonomikë. Kriteret e për zgjedhjes nuk duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që tejkalon qëllimin për të cilin janë vendosur.

Në rastin konkret, kriteri është interpretuar në mënyrë formale dhe restriktive, pa u vlerësuar përmbajtja reale e kualifikimit profesional të personit të propozuar.

Për më tepër, vetë Dosja e Tenderit, për përkthyesit në “gjuhë tjera”, e njeh shprehimisht aktvendimin apo vërtetimin valid për interpret gjyqësor si alternativë ndaj diplomës universitare. Kjo dëshmon se vetë Autoriteti Kontraktues e konsideron licencën/vërtetimin për interpret gjyqësor si dokument relevant për dëshmimin e kapacitetit profesional gjuhësor.

Në këto rrethana, mosmarrja në konsideratë e licencës së vlefshme për gjuhën serbe, së bashku me faktin se arsimi universitar i personit është zhvilluar në gjuhën serbe, e bën vendimin për eliminim të paarsyetuar në raport me qëllimin e kriterit profesional.

VI. DËMI DHE INTERESI JURIDIK I ANKUESIT

FINART SH.P.K. është operator ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin konkret të prokurimit dhe, si rezultat i eliminimit të kundërshtuar, është përjashtuar nga mundësia për t’u vlerësuar dhe për të konkurruar për dhënien e kontratës.

Rrjedhimisht, FINART SH.P.K. ka interes të drejtpërdrejtë juridik dhe ekonomik për kundërshtimin e vendimit dhe rrezikon të pësojë dëm material si rezultat i eliminimit të ofertës së tij.

VII. KËRKESA E ANKUESIT

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, FINART SH.P.K. i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që:

1. TA APROVOJË si të bazuar ankesën e FINART SH.P.K.;
2. TA ANULOJË vendimin e Autoritetit Kontraktues në pjesën që ka të bëjë me eliminimin e FINART SH.P.K.;
3. TA KTHEJË aktivitetin e prokurimit në rivlerësim;
4. TA URDHËROJË Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të shqyrtojë në tërësi kualifikimin profesional të përkthyesit të propozuar për gjuhën serbe, përfshirë licencën e vlefshme profesionale, arsimin universitar të zhvilluar në gjuhën serbe dhe përvojën profesionale;
5. TA URDHËROJË Autoritetin Kontraktues që, nëse konsideron se ekziston paqartësi lidhur me dokumentacionin e këtij përkthyesi, të kërkojë sqarim në pajtim me dispozitat përkatëse të LPP-së dhe Dosjes së Tenderit, në vend të eliminimit automatik

të tenderit;

6. Të ndërmarrë çdo masë tjetër që OSHP e konsideron të nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë aktivitet të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Jemi përjashtuar nga mundësia për të u vlersuar dhe për të konkuruar për dhenie të kontrates.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.